



Pranuar / Dorezuar Prijeljeno/Prodato Received/Delivery		28.12.2022	2	viti god. year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSK	8494/2022		1/2	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1175/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1175/2022 të datës 14.12.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit, Ministria e Zhvillimit Rajonal në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1175/2022 e datës 14.12.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar ne pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Integritet Evropian", në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me datën 14.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 8032/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore duke kërkuar sqarime apo opinion, nëse zyrtarët publikë kanë të drejtë të marrin pjesë në debate televizive, intervistojmë jashtë orarit të punës për tema politike apo opinione në portalet e ndryshme elektronike me tema politike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 14.12.2022 me numër protokollit 8032/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë lidhur me presionin për shprehjen e mendimit të lirë dhe publik jashtë orarit të punës e parashtruar në organin e punësimit përmes emailit zyrtar të datës 13.12.2022; E-maili i datës 21.11.2022 dërguar



Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe disa foto të ankuesit i cili i dërgoi përmes e-mailit zyrtar të datës 22.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga pala në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", andaj ndërlikur me këtë Kolegji vlerëson se mbi bazën e arsyeve të kundërshtuara me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.1175/2022 e datës 14.12.2022, e parashtruar nga ankuesi është e palejuar.


Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1175/2022, datë 28.12.2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet;**

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

